

Kthim pergjigje Nr. 168 Mon 5/11/2020 7:27 PM

To: Tedi HIBRAJ <tedi.hibraj@gmail.com>;

Pershendetje Z. Hibraj!

Ne pergjigje te kerkeses tuaj derguar elektronikisht ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve, ne kuader te Ligjit 119/2014 date 18.09.2014 "Per te drejten e informimit", regjistruar me nr. 168 në regjistrin e Kerkesave dhe Pergjigjeve, duke ju falenderuar per kontributin tuaj ne denoncimin e rastit dhe venien ne dispozicion te materialeve qe dispononit, sqarojme si me poshte vijon:

Me date 06.03.2020 eshte regjistruar Informacioni mbi rastin abuziv nr. 148.

Ne kuader te verifikimit te problematikave te rastit, jane kryer veprime verifikuese, si kontroll dhe verifikim i dokumentacionit sipas objektit dhe detyrave te Drejtorisë së Hetimit Tatimor mbështetur në zbatim të kërkesave të Nenit 105, të Ligjit Nr. 9920 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke zbatuar kërkesat e VKM Nr. 400, datë 22.04.2009, "Për përcaktimin e detyrave dhe funksioneve të Drejtorisë së Hetimit Tatimor", në Manualin e Hetimit Tatimor si dhe në Urdhërat dhe porositë e dala për zbatim për DHT.

Per sa me siper, me qellim verifikimin e pretendimeve te ngritura nga ju, ne bashkepunim me Sektorin e Monitorimit eshte kryer kontroll ne subjektin Log In Territorial Albania me NIPT K51325001V, ne baze te ligjit nr. 9920, date 19.05.2008, i ndryshuar dhe nga kontrolli i ushtruar nuk rezultoi qe subjekti te kishte shkelje administrative.

Nga ana e Sektorit te Hetimit Tatimor eshte administruar dokumentacion i cili po analizohet.

Ne lidhje me dokumentacionin e dorezuar nga ju, dokumentacion ky qe e disponon Sektori i Hetimit Tatimor, po pergatiet materiali per t'ia derguar per Vleresim Tatimor, Drejtorise se Tatimpaguesve te Medhenj.

Rasti eshte ne ndjekje dhe do te trajtohet sipas afateve dhe kerkesave ligjore.

Faleminderit per mirekuptimin.

Pune te mbare

Hermelinda Hysenaj
Specialiste e Sektorit te Asistences dhe Sherbimit
Drejtoria e Sherbimit ndaj Tatimpaguesve

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Tel Office : 04 2276 840

Web: www.tatime.gov.al